



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2023

Lënda: Përgjigje kërkesës së paraqitur nga Z. F.T.
Adresa: _____

I nderuar z. T,

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion nr 822 prot. datë 26.04.2023 (tonën), dërguar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit“, për informacion lidhur me statusin e shqyrtimit të kërkesave për korrigjim të dhënash, ju informojmë si më poshtë:

Së pari baza ligjore në kërkesën tuaj për informacion, është vendosur bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit“, ligjin nr. 45/2015 i ndryshuar dhe Rregulloren e Autoritetit.

Por nga shqyrtimi i objektit të kërkesës, (statusi i shqyrtimit të kërkesave për korrigjim të dhënash të dokumentacionit arkivor të pasqyruar në Vendimin nr. 394 datë 29.07.2022 të Autoritetit në emrin tuaj) vërehet se kërkesa juaj për informacion i nënshtrohet dispozitave procedurale për mënyrën se si të merret informacioni, sipas dispozitave njohëse të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar“.

Në këtë kontekst ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit“, gjen zbatim dhe mbetet i aplikueshëm kur është e mundur dhe nuk bie ndesh me ligjin organik nr. 45.2015 që normon veprimtarinë funksionale të Autoritetit, por edhe me ligjin për arkivat pasi informacioni që kërkohet sipas objektit të kërkesave për korrigjim të dhënash është dokumentacion arkivor.

Sa më sipër, nuk kemi të bëjmë me informacion publik në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të ligjit nr 119/2014 “Për të drejtën e Informimit“.

Në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, kërkesa juaj është përcjellë në strukturat përkatëse për tu trajtuar. Nga komunikimi me këto struktura, rezulton informacioni se : Z. T. i është drejtuar Autoritetit me kërkesën nr. 1281 prot., në datën 27.07.2022 dhe Autoriteti ka dalë me Vendimin nr. 324 datë 29.07.2022. Me shkresën nr. 1344 prot. datë 03.08.2022, Z. T. i është drejtuar përsëri Autoritetit. Në përgjigje të shkresës nr. 1344 prot., datë 03.08.2022, “Kërkesë”, Z. F.T., është informuar se ka filluar trajtimi i kërkesës sipas objektit duke konstatuar gjithashtu se në kërkesën për korrigjim të paraqitur, nuk ka të bashkëlidhur akte apo shkresa që të ndihmojnë institucionin në identifikimin e pasaktësive.

Z. T. dërgon përsëri në Autoritet, një kërkesë me nr. 1344/2 prot. datë 10.10.2022 e cila është në trajtim.

Për mbylljen e praktikës tuaj nga ana e Autoritetit, lidhur me kërkesat për korrigjimin e të dhënave të dokumentacionit arkivor të pasqyruar në Vendimin nr. 394 datë 29.07.2022 të

Autoritetit në emrin tuaj, do të njoftoheni nga strukturat përkatëse me shkresë në adresën e paraqitur në kërkesën drejtuar Autoritetit.

Së dyti ; Sa i takon pretendimit të ngritur se mbledhja është mbajtur në kushte të “fshehta” duke cënuar funksionin dhe misionin objektiv që duhet të ketë institucioni, ju informojmë se në zbatim të nenit 1 pika 3 të ligjit nr 45/2015 i ndryshuar, Autoriteti “Në funksion të zbatimit të këtij ligji, i referohet dhe zbaton legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, për aq sa është e mundur, edhe legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit, arkivat dhe informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” Legjislacioni në fuqi për funksionimin e organeve kolegjiale si dhe Kodin e Procedurave Administrative.

Në zbatim të nenit 24 të Rregullores për Oganizimin dhe funksionimin e Autoritetit, rastet kur mbledhja duhet të bëhet e hapur vlerësohet nga vetë Autoriteti me respektimin e kritereve dhe të procedurës përkatëse.

Sa më sipër, të gjitha mbledhjet e Autoritetit përfshirë edhe mbledhjen e datës së referuar në shkresë, nuk janë publike ose të hapura.

Bashkëlidhur do të gjeni Vendimin nr. 276 datë 04.05.2023 të Autoritetit për zgjatjen e afatit kohor për shqyrtimin e kërkesës për korigjim për pasaktësi.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin,

Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit

L. Cocoli

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Suela Prenci